

**Njoftim i përqendrimit me të cilin Salus, Lublana, d.d., Slloveni do të fitojë kontrollin e vetëm mbi
MEDITREJD, Shoqëria për tregti të jashtme dhe të brendshme d.o.o. nga Slloveni**

(lënda nr. 08-26 2023)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 26.01.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftimi i përqendrimit, i cili i referohet fitimit të kontrollit të vetëm nga Salus, Lublana, d.d. me seli të regjistruar në Litostrojska cesta 46A, 1000 Lubjanë, Slloveni mbi MEDITREJD, Shoqëria për tregti të jashtme dhe të brendshme d.o.o. me seli në rrugën Brnçiçeva 17B, 1231 Lubjanë - Çrnuce, Slloveni, përmes shitblerjes së 100% të aksioneve në MEDITREJD, Shoqëria për tregti të jashtme dhe të brendshme d.o.o. Slloveni.

- **Salus, Lublana, d.d.** është një shoqëri me bazë në Lubjanë dhe shoqëria mëmë e Grupit Salus. Grupi Salus gjeneron shumicën e të ardhurave të tij nëpërmjet ndërmarrjeve-bijë të tij SALUS Tregti me shumicë, d.o.o. dhe Sanolejbor d.d. aktiviteti kryesor i të cilit është tregtia me shumicë (SALUS Tregtia me shumicë dhe Sanolejbor) dhe tregtia me pakicë (Sanolejbor) me barna, produkte farmaceutike, ndihma mjekësore, pajisje dhe materiale mjekësore. Shoqëritë brenda Grupit Salus ofrojnë gjithashtu shërbime magazinimi, rregullatorë, shërbime farmakovigjilencës, marketingu dhe promovim farmaceutik, farmakoekonomi. Salus (si shoqëria mëmë e Salus Group) është aktive kryesisht në fushën e investimeve dhe menaxhimit të pasurive të paluajtshme.

Në Maqedoninë e Veriut, Salus, Lublana d.d. Aktivitetet e biznesit i ushtron nëpërmjet shoqërisë bijë **Carso Internacional, shpknjp llinden** me seli në rrugën 34 nr.5, llinden. Aktivitetet e saj janë përfaqësimi dhe marketingu i markave tregtare të prodhuesve kryesorë të produkteve farmaceutike.

- **MEDITREJD, Shoqëria për tregti të jashtme dhe të brendshme d.o.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me seli në Lubjanë. Shoqëria është aktive në tregtimin me shumicë të pajisjeve mjekësore. Klientët kryesorë të shoqërisë janë institucionet shëndetësore, me të cilat shoqëria synon, ndër të tjera, të kontribuojë në një nivel të lartë të kujdesit shëndetësor për popullatën.

MEDITREJD, Shoqëria për tregti të jashtme dhe të brendshme d.o.o. nuk ka fonde dhe nuk ka bërë asnjë qarkullim në Maqedoninë e Veriut në vitin 2021.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

30.01.2023

Shkup